

**AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Hotel Relux" sh.p.k**

Sot me date 27.01.2023 , ne Tirane, :

Ermal Mamaqi, atesia Drini i datëlindjes 21/03/1982 identifikuar me kartë ID me nr. Personal I20321141F lindur në Tirane dhe banues në Tirane ka vendosur te nenshkruaje kete Akt Themelimi per krijimi e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"Hotel Relux" sh.p.k** Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi si vijon.

Neni 1

Emertimi

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **"Hotel Relux" sh.p.k**

Neni 2

Objekti

Shoqeria ka per objekt:

- a. Veprimtari dhe sherbime hotelerie qe lidhen me akomodimin ne hotel dhe turizmi, sherbime restorantesh, organizime festash, ceremoni zyrtare, konferenca, seminare, trajnime, panaire, organizime eventesh, takime biznesi, aktivitetekulturore dhe argetuese;
- b. Bar dhe restorant, pishine, sauna, fitness, sherbime banketi, sherbime transporti, sherbim parkimi.
- c. Studio projektimi, Germim dhe transportim dheu, Transport kombetar e nderkombetar mallrash e udhetaresh, ne rruge detare, tokesore apo ajrore,
- d. Ne fushen e ndertimit, punime ndertimi, projekttime, prodhim materiale ndertimi, mbikqyrje, kolaudim, etj. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore
- e. Ndërmjetësim në shitje dhe dhënie me qera pronash të Paluajtshme
- f. Krijim, zhvillim zyra ndermjetësimi, plane, mjete marketingu, për pasuritë e paluajtshme deri në nëshkrimin e kontratës; perfaqesim

pronaresh, perfaqesim investitoresh ne lidhje me sektorin e Pasurive te Paluajtshme, Administrim dhe Menaxhim Projektesh.

- g. Dhënie konsulence për sigurimin e pasurive të paluajtshme dhe asistence ne Sigurime;

Neni 3

Selia

- a) Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen Tirane ,Rruga Ali Shefqeti, Godine Banimi dhe sherbime 1.6 dhe 7 kate me 2 kat parkimi nentoke Tirane Dajt DAJT Tufine, prane Poliklinikes shteterore .Zona kadastrale Nr.8170 Nr.Pasurise 10/127
- b) Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojë filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin pa afat. Asamblea Ortakeve me vendim mund te vendose nje afat per kohezgjatjen e Shoqerise.

Neni 5

Kapitali

- a) Kapitali i shoqërisë tregtare private "**Hotel Relux" sh.p.k.**, do te jete 100.000 Leke (njqindmije).Kapitali i shoqerise ndahet , ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga ortaku ne shoqeri,ku ortaku zoteron 1(nje) kuote te vetme .Kuoto kjo e shlyer teresisht nga ortaku dhe e ndere si meposhte :
- Ermal Mamaqi, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (pesedhjetemije) Leke qe perben 100% (njqind perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.**
- b) Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme/ te drejta).
- c) Pergjegjesia e ortakeve per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

Neni 6

Organi vendimmarres

- a) Asambleja e ortakeve eshte i vetmi organ vendimmarres i shoqerise .
- b) Vendimet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme ,per te cilat kerkohet nje shumice thjeshte ose e kualifikuar , jane te vlefshme vetem nese jane te pranishme ortaket qee perfaqesojne me shume se 51% te Kapitalit Themeltare .
- c) Vendimet qe merr kjo asamble me shumice votash , jane te detyrueshme per ortaket qe mungojne ose qe kane mendim te kundert . Ortaket kane te drejten e ankimit , te cilin mund ta ushtrojne ne rastet, kohen dhe format qe lejon ligji .

Neni 7

Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem i emeruar nga Asambleja e Ortakeve.

Administratori i Shoqerise eshte:

Ermal Mamaqi, atesia Drini i datëlindjes 21/03/1982 identifikuar me kartë ID me nr. Personal I20321141F lindur në Tirane dhe banues në Tirane .

Administratori ka tagra te meposhtme:

- administron Shoqerine ne zbatim te politikave tregtare te percaktuara nga asambleja e ortakeve;
- perfaqeson shoqerine;
- emeron perfaqesues te pergjithshem ose te posaçem per çeshtje te veçanta dhe vendos mbi shkarkimin e tyre;
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise;
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, raportin mbi ecurine e veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet ne Asamblene e Ortakeve per miratim;
- kryen regjistrimet e detyrueshme te parashikuara nga regjistri tregtar;

- informon Asamblene e Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
- pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;
- te emeroj financiar e konsulentë për problemet e shoqërisë.
- te lidhi marrëveshje me te trete ne kufijtë e objektit te aktivitetit te shoqërisë dhe te kompetencave te percaktuara nga ortaket;
- te shpërblehet për punën qe kryen sipas marrëveshjes me ortaket themelues.
- te thërrasi asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave te përcaktuara ne ligj;
- te kryej veprime/transaksione ne llogarite rrjedhese te shoqerise me vlera te pakufizuara, perfshire nenshkrimin e kontratave me te trete.

Administrimi i shoqerise me vendim te asamblese se ortakeve mund te behet dhe nga nje ose me shume administratore te cilet mund ta administrojne se bashku ose veçmas shoqerine sipas vendimit perkates te asamblese.

Administratori shkarkohet nga detyra nga asambleja e ortakeve ne rastet si me poshte:

- shkarkohet nga asambleja per shkak se nuk permbush detyrat qe i jane caktuar nga statuti dhe ligji, ben mungesa te pajustificuara per me shume se tre muaj ose nuk eshte me i afte per t'i permbushur ato;
- jep doreheqjen dhe j'a komunikon ate asamblese, jo me vone se 30 dite para dates se largimit.

Neni 8

Viti Financiar dhe Bilanci

- a) Viti Financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht per vitin e themelimit te Shoqerise, viti financiar fillon nga data e themelimit .
- b) Ne rast prishje dhe likujdimi te Shoqerise, ne çdo moment dhe per çdo arsye, emerimi i likuidatorit do te miratohen me vendimin e Asamblese se Ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 9

Dispozitat e fundit

Ky akt-themelimi i shoqërisë “**Hotel Relux**” sh.p.k u hartua ne baze te vullnetit te lire te themelueses, ne mbështetje te dispozitave përkatëse te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ i ndryshuar, dhe u hartua ne 4 (kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe, te cilat u nenshkruan rregullisht nga ortaket e saj.

Ortaku themelues i shoqerise

Administrator

Ermal Mamaqi



STATUT
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Hotel Relux”
Kreu I
Themelimi, Emri,Objekti,Kohëzgjatja

Neni 1
Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot me date 27.01.2023 , ne Tirane ne themeluesit, kemi krijuar, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “**Hotel Relux**”shpk,.

2.Themeluesit e Shoqërisë:

- Ermal Mamaqi, atësia Drini i datëlindjes 21/03/1982, identifikuar me kartë ID me nr. Personal I20321141F lindur në Tirane dhe banues në Tirane.

Neni 2
Objekti

1.Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a. Veprimtari dhe shërbime hotelerie qe lidhen me akomodimin ne hotel dhe turizmi, shërbime restorantesh, organizime festash, ceremoni zyrtare,konferenca, seminare, trajnime,panaire, organizime eventesh, takime biznesi, aktivitetekulturore dhe argetuese;
- b. Bar dhe restorant, pishine, sauna, fitness, shërbime banketi, shërbime transporti,shërbim parkimi.
- c. Studio projektimi,Germim dhe transportim dheu, Transport kombetar e nderkombetar mallrash e udhetaresh, ne rruge detare, tokesore apo ajrore,
- d. Ne fushen e ndertimit, punime ndertimi, projekte, prodhim materiale ndertimi, mbikqyrje, kolaudim,etj. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore
- e. Ndërmjetësim në shitje dhe dhënie me qera pronash të Paluajtshme
- f. Krijim, zhvillim zyra ndermjetësimi, plane, mjete marketingu, për pasuritë e paluajtshme deri në nëshkrimin e kontratës; perfaqesim pronaresh, perfaqesim investitoresh ne lidhje me sektorin e Pasurive te Paluajtshme, Administrim dhe Menaxhim Projektesh.

Dhënie konsulence për sigurimin e pasurive të paluajtshme dhe asistence ne Sigurime

Neni 3
Kohëzgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin pa afat. Asamblea Ortakeve me vendim mund te vendose nje afat per kohezgjatjen e Shoqërisë.

Neni 4
Selia



- a) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Tiranë, Rruga Ali Shefqeti, Godinë Banimi dhe shtëpi 1.6 dhe 7 kate me 2 kat parkimi nëntokë Tiranë Dajt DAJT Tufinë, pranë Poliklinikës shtetërore. Zona kadastrale Nr.8170 Nr.Pasurisë 10/127
- b) Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqëse dhe të krijojë filiale në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali Themeltar


- a) Kapitali i shoqërisë tregtare private "**Hotel Relux**" sh.p.k., do të jetë 100.000 Leke (njëqindmijë). Kapitali i shoqërisë ndahet, në një numër kuotaash në raport me kontributin e dhënë nga ortakët në shoqëri, ku ortakët zoteron 1 (një) kuota të vetme. Kuota kjo e shlyer teresisht nga ortakët dhe e ndere si mëposhte :
Ermal Mamaqi, zotëruar i 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme 100.000 (pesëdhjetmijë) Leke që përben 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- b) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme/ të drejta).
- c) Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë shtrihet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para, dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve.
2. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
3. Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë, ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i Kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.



2.Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme, por duke ezauruar si procedurë fillestare të drejtën e parablerjes.

Kreu III

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarrës

- 1.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 3.Asambleja e Ortakëve, është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) miratimin e kontratave për nenlicencimin e franshizmarresve për përdorimin e markes;
 - j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4.Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblesën e Ortakëve, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.
- 5.Administratori, nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblesën e Ortakëve.
Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesës së Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesës së Ortakëve

1. Asambleja e Ortakëve, thirret, nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik, duhet të



përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

2. Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë

vendime të vlefshme, vetëm, nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të "Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse Asambleja e Ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit, të

përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

1. Asambleja e Ortakëve, vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen efitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Për çështjet e tjera të përmendura në nenin 8, Asambleja e Ortakëve, vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Cdo ndryshim statuti duhet të regjistrohet në QKB, për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.


Neni 12

Përgjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes, nëse Asambleja e Ortakëve merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



Neni 13

Administrimi

Shoqëria administrohet nga nje Administrator i vetem i emeruar nga Asambleja e Ortakëve.

Administratori i Shoqërisë është:

Ermal Mamaqi, atesia Drini i datëlindjes 21/03/1982 identifikuar me kartë ID me nr. Personal I20321141F lindur në Tirane dhe banues në Tirane madhor me zotësi i vlefshëm për një afat 5 vjecar, me të drejtë rizgjedhje..

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

1.Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar

politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakëve;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë, e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së

veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Ortakëve për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi, në kohën e duhur, për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raporton përpara Asamblesë së Ortakëve, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;


ë) Kryen detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2.Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve kur:

-sipas bilancit vjetor, apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme, brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë, apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



3.Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 15 **Përgjegjësitë e Administratorit**

1.Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

2.Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme për besnikërinë, sipas neneve 14,15,17, e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj, ose në statut, në mirëbesim, e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj, ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të

përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi, çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve, sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojë detyrat e tij, me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat, dhe shkel standartet profesionale të caktuara më sipër, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, si dhe të kalojë cdo përfitim që ai apo persona të lidhur me të, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.


4. Administratori është përgjegjës, edhe për çdo detyrim tjetër, që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, por që rrjedh nga ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 16 **Viti Financiar**

1.Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar, dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë ne QKB, dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Kreu IV **Prishja/Riorganizimi i shoqërisë**

Neni 17 **Prishja/Likuidimii Shoqërisë**



1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet, dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, nëpërputhje me pikën 3 të nenit 43, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

2. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë.

3. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar, mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Riorganizimi i Shoqërisë

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, në përrputhje me dispozitat ligjore, të parashikuara në pjesën IX të ligjit, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 19

Baza ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, në përrputhje me këtë statut, dhe legjislacionin shqiptar.

2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin, për zbatimin e interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të trëtëve, do të jenë kompetente gjykatat shqiptare.

Ortakët

e Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar "Hotel Relux" shpk

Z. Ermal Mamaqi

